

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Ardian Ajvazi, në çështjen juridike, sipas padisë së paditësit [REDACTED] nga [REDACTED] Rr. [REDACTED], të cilin me autorizim e përfaqëson avokati [REDACTED] nga [REDACTED], kundër të paditurit [REDACTED] ish nga [REDACTED], tani me adresë të panjohur, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm avokati [REDACTED] nga [REDACTED], lidhur me vërtetimin e të drejtës së pronësisë, vlera e objektit të kontestit 150,000.00 Euro, me datë 19.04.2017, merr këtë:

AKTGJYKIM

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit [REDACTED] nga [REDACTED] ushtruar kundër të paditurit [REDACTED] ish nga [REDACTED], lidhur me vërtetimin e të drejtës së pronësisë në pjesën ideale prej 2/4 të ngastrës kadastrale P-72809093-02107-4, në vendin e quajtur "Kryq", e regjistruar në Çertifikatën për të drejtat pronësore UL-72809093-00458 ZK Shtime.

II. VERTETOHET se paditësi [REDACTED] nga [REDACTED] Rr. [REDACTED], e ka fituar të drejtën e pronësisë në pjesën ideale prej 2/4 të ngastrës kadastrale P-72809093-02107-4 me sipërfaqe prej 582 m2, në vendin e quajtur "Kryq", e regjistruar në çertifikatën për të drejtat pronësore UL-72809093-00458 ZK [REDACTED] mbi bazën e parashkrimit fitues.

III. DETYROHET i padituri [REDACTED] ish nga [REDACTED], tani me adresë të panjohur që paditësit [REDACTED] nga [REDACTED] t'ia pranojë të drejtën e pronësisë së pjesën ideale prej 2/4 të ngastrës kadastrale P-72809093-02107-4, në vendin e quajtur "Kryq", e regjistruar në çertifikatën për të drejtat pronësore UL-72809093-00458 ZK Shtime, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përbarimit të detyrueshëm.

IV. DETYROHET paditësi [REDACTED] nga [REDACTED] që në llogarinë e kësaj Gjykate të paguan taksën prej 500,00 Euro për përpilimin e këtij Aktgjykimi, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të të njëjtit, nën kërcënimin e përbarimit të detyrueshëm.

Arsyetimi

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes së fakteve të çështjes, për aq sa palët ndërgjyqëse përmbushin detyrimin e tyre për t'i parashtruar ato, në kuptim të nenit 7.1 të LPK-së, Gjykata ka administruara një sër provash:

Dëshmitari [REDAKTUAR] deklaron: palët ndërgjyqëse i kam vëllezër, në vitin 1972 së bashku me paditësin unë e kam blerë parcelën kontestuese me Nr. 21-07 prej [REDAKTUAR] me çmimin prej 40 milion dinarë të cilin çmim e kemi paguar në tërësi dhe po ashtu [REDAKTUAR] e ka pranuar çmimin shitblerës. Prej kësaj kohe kur është blerë kjo paluajtshmeri ne jemi në posedim të qetë të papenguar nga askush, në pjesën time unë kam ndërtuar shpijen 2 katëshe pas luftës, ndërsa vëllau e ka ndërtuar para luftës së fundit në Kosovë, është e vërtet që gjysma e kësaj parcele i takon vëllaut tim 2/4 e parcelës 2107/4.

Dëshmitari [REDAKTUAR] deklaron: palët ndërgjyqëse i kam djem të axhës me sa më kujtohet mua rreth viteve të 80-ta [REDAKTUAR] e ka blerë prej vëllaut të tij [REDAKTUAR] parcelën 2107/4 për çmimin rreth 40 milion dinar të cilin çmim e ka pranuar i padituri dhe këtë parcel e shfrytëzon paditësi i papenguar nga askush deri tani. Në parcelën kontestuese është ndërtuar shtëpia nga fëmijët e paditësit, në të cilën shtëpi banon djali i paditësit me emrin [REDAKTUAR], i cili gjendet me punë të përkohshme në [REDAKTUAR]. I padituri nuk ka pretenduar prej momentit të shitjes në parcelën objekt kontesti.

Është bërë edhe nxjerrja provave dhe atë Çertifikata e Pronësisë e datës 25.07.2012, së bashku me skicat e matjes, informata e zyrës së gjendjes civile në Komunën e Shtimes e datës 01.07.2016, ekspertiza e ekspertit gjeodet e datës 06.02.2017.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve dhe provave të lartë cekura, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se padia e paditësit është në tërësi e bazuar.

Nga deklarimi i dëshmitarëve Gjykata vërtetoi shfrytëzimin me mirëbesim më shumë se 20 vite 2/4 e parcelës kadastrale P-72809093-02107-4, në vendin e quajtur "Kryq", e regjistruar në Çertifikatën për të drejtat pronësore UL-72809093-00458 ZK [REDAKTUAR], pra në rastin konkret janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për njohjen e të drejtës së pronësisë paditësit mbi bazën e parashkrimit fitues. Periudha e parashkrimit fillon të llogaritet nga dita e marrjes në posedim të sendit, kurse përfundon pas kalimit të ditës së fundit të periudhës së paraparë për këtë posedim, e në rastin konkret është kalimi i kohës prej 20 viteve për sendet e paluajtshme. Periudha e parashkrimit nënkupton mundësinë e fitimit të pronësisë nëpërmjet të posedimit nga ana e jopronarit, me kusht që rezultati përfundimtar të jetë fitimi i së drejtës së pronësisë. Përveç posedimit të pandërprerë, parakushte të tjera mund të jenë edhe origjina e sendit, mënyra e arritjes deri te posedimi. Në rastin konkret kemi shfrytëzim dhe fitim me mirëbesim të ngastrës objekt shqyrtimi, pra kemi fitim derivativ të posedimit. Fitimi derivativ i posedimit ekziston



ndryshuar me vendimet e KGJK-së me numër 20/2012 dhe 37/2012, të aprovuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Andaj nga të cekurat më lartë konform nenit 143 të LPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ
C.nr.479/12, me datë 19.04.2017

Gjyqtari,
Arđan Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të kopjes së tij, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e të dorëzohet përmes kësaj Gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC.

20.06.2017